



REPUBLIKË E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO  
 GOVERNMENT - VLADETA  
 Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister  
 AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË  
 AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO  
 FOOD AND VETERINARY AGENCY  
 NR. BR. NO. 1521  
 DR. 19.03.19 PRISHTINË-A  
 N. 1000. No. 5

**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova – Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*  
 Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera- Office of the Prime Minister

**AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË**  
**AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO**  
**FOOD AND VETERINARY AGENCY**

 Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarise  Manuali	<b>PSO</b>  <b>Procedurat Standarde të Operimit për monitorim</b>	<b>Dok.-Nr.:07-109-003</b> <b>Versioni:</b> 1.0. <b>Faqe:</b> 5 <b>Statusi:</b> 31.01.2019.
--	---	--

<b>Titulli:</b>	<b>Procedurat Standarde të Operimit për monitorim</b>	
<b>Qëllimi:</b>	Administrata Fitosanitare	
<b>Fjalët kyçë:</b>	Monitorimi, inspektori fitosanitar, planifikimi, dëmtuesi, monitorimi i përgjithshëm, monitorimi i veçantë, inspektimi vizual, kontrolli i dokumenteve, mostrimi, raporti i inspektimit	
<b>Legjislationi dhe dokumentet relevante</b>	LIGJI NR. 04/L-120 PËR MBROJTJEN E BIMËVE	
<b>Referencat e tërthortë</b>	Procedura e monitorimit për identifikimin e dëmtuesve dhe përhapjen e tyre Planifikimi dhe zbatimi i monitorimit Llojet e monitorimit Dokumentimi i monitorimit	

<b>Hartuar nga:</b>	Naim Delijaj – Inspektor fitosanitar Ismet Fejzullahu – Shef i Sektorit të Inspektoratit Fitosanitar - AUV Islam Mulaj – Inspektor fitosanitar kufitar Izet Imeri - Inspektor fitosanitar kufitar Agita Pence - ekspert i shtetit anëtar të BE Gunita Škupele - ekspert i shtetit anëtar të BE	Data: 28.01.2019.
<b>Bashk nënshkruar nga:</b>	Ilirjana Zymberaj - Drejtoreshë e Inspektoratit të AUV	Data: 18/03/2019
<b>Miratuar nga:</b>	Kujtim Uka – Menaxher i Ollësisë	Data: 18/03/2019

Përfundimisht nënshkruar nga:	Valdet Gjinovci - Kryeshef Ekzekutiv I AUV-së <i>Alfons Gjinovci</i>	Data: 19.03.2019
Në fuqi që nga:		Data:

Arsyeja për përditësimin e fundit:		Data:
Përditësimi i fundit:		Data:
Përditësimi i bashknënshkruar:		Data:
Miratuar nga:		Data:
Përditësimi përfundimisht I nënshkruar nga:		Data:

#### Përbajtja

I Dispozitat e përgjithshme .....	3
II Planifikimi dhe zbatimi i monitorimit .....	3
2.1.Zgjedhja e dëmtuesve për monitorim .....	3
2.2.Monitorimi i përgjithshëm .....	4
2.3.Monitorimi i veçantë .....	4
III Dokumentimi i monitorimit .....	5

 Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	<b>PSO</b> <b>Procedurat Standarde të Operimit për monitorim</b>	<b>Dok.-Nr.: 07-109-003</b> <b>Versioni:</b> 1.0. <b>Faqe:</b> 5 <b>Statusi:</b> 31.01.2019.
Manuali		

## **Procedurat Standarde të Operimit për monitorim**

### **I Dispozitat e përgjithshme**

1. Kjo procedurë e operimit përcakton procedurën, se si Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (në tekstin e mëtejmë - AUV) kryen monitorimin për të identifikuar dëmtuesit dhe përhapjen e tyre.
2. Monitorimi - grumbullimi i të dhënavës sistematike, të vazhdueshme, të rregullta, periodike dhe mbledhja e përsëritur afatgjatë e të dhënavës, përpunimi dhe analiza e tyre.
3. Llojet e monitorimit:
  - 3.1. monitorimi i përgjithshëm;
  - 3.2. monitorimi i veçantë.
4. Monitorimi mund të jetë:
  - 4.1. vizual;
  - 4.2. vizual me mostrim;
  - 4.3. vizual me kontroll dokumentesh;
  - 4.4. vizual me mostrim dhe kontrollimin e dokumenteve.
5. Rezultatet e monitorimit përdoren:
  - 5.1. për të mbledhur informacion rreth gjendjes fitosanitare dhe ndryshimeve të saj;
  - 5.2. për të përcaktuar përhapjen e dëmtuesve;
  - 5.3. për të vendosur masa fitosanitare dhe për të kontrolluar efikasitetin e tyre;
  - 5.4. për të bërë kontroll fitosanitar;
  - 5.5. për parashikime;
  - 5.6. për analizën e rrezikut të dëmtuesve;
  - 5.7. për të krijuar zona pa dëmtues.
6. Një inspektor fitosanitar (në tekstin e mëtejmë - inspektori) kryen monitorim sipas planit vjetor të mbikëqyrjes së AUV në kohën optimale, kur simptomat e dëmtuesve mund të shihen.
7. Mostrat merren me ose pa simptoma vizuale siç shpjegohet në udhëzuesit specifik të brendshëm të AUV.

### **II Planifikimi dhe zbatimi i monitorimit**

#### **2.1.Zgjedhja e dëmtuesve për monitorim**

8. Sektori Fitosanitar i AUV (në tekstin e mëtejmë - Sektori Fitosanitar) përcakton dëmtuesit për të cilat monitorimi (për të identifikuar dëmtuesit dhe përhapjen e tyre) është i nevojshëm duke marrë parasysh:
  - 8.1. kërkesat e mbikëqyrjes të vendosura në bazë të Ligjit për mbrojtjen e bimëve në Kosovë;

 Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë	<b>PSO</b> <b>Procedurat Standarde të Operimit për monitorim</b>	<b>Dok.-Nr.: 07-109-003</b> <b>Versioni:</b> 1.0. <b>Faqe:</b> 5 <b>Statusi:</b> 31.01.2019.
<b>Manuali</b>		

- 8.2. përhapjen e dëmtuesve të rinj, potencialisht të rrezikshëm në vendet fqinje të Kosovës dhe Bashkimin Evropian;
- 8.3. nevojën për të vlerësuar statusin e dëmtuesve të bimëve karantinore në Kosovë;
- 8.4. nevojat për analiza të rezikut të dëmtuesve.
9. Nëse monitorimi është planifikuar për organizmat për të cilët monitorimi nuk është bërë kurrë:
- 9.1. Sektori fitosanitar në bashkëpunim me Institut Bujqësor të Kosovës ose institucione tjera shkencore i përgatit informacione për kohën më të përshtatshme për monitorim duke marrë parasysh biologjinë e dëmtuesve, bimët strehuese, vendet e inspektimit, grumbullimin e mostrave dhe përgatitjen e tyre për dërgimin në laborator etj.;
- 9.2. Sektori Fitosanitar përgatit kërkesa themelore për monitorim (duke përfshirë kriteret për zbulimin e zonave të rrezikshme) dhe i përfshin ato në udhëzuesin vjetor për kontrolla (në vijim - udhëzuesi).
10. Plani vjetor i monitorimit miratohet nga kryeshefi ekzekutiv.

## **2.2. Monitorimi i përgjithshëm**

11. Monitorimi i përgjithshëm përdoret për të karakterizuar gjendjen e përgjithshme fitosanitare dhe ndryshimet e saj në tërë territorin e Republikës së Kosovë.
12. Monitorimi i përgjithshëm bëhet në kopshte botanike, parqe private ose publike në fidanishte ku rritet materiali për shumim.

## **2.3. Monitorimi i veçantë**

13. Monitorimi i veçantë përdoret për organizëm specifik të dëmshëm ose për sqarimin specifik të procesit në territorin e caktuar.
14. Monitorimi i veçantë përdoret:
- 14.1. për të identifikuar praninë e një dëmtuesi specifik ose shpërndarjen e tij;
- 14.2. për analizën e rrezikut të dëmtuesve - për të vlerësuar aspektet specifike;
- 14.3. për të vlerësuar masat fitosanitare;
- 14.4. për të përcaktuar masat fitosanitare dhe për të kontrolluar efektivitetin e tyre;
- 14.5. për të kryer kontroll fitosanitare;
- 14.6. për të krijuar zona të lira prej dëmtuesve.
15. Monitorimi i veçantë do të përdoret nëse:
- 15.1. në Kosovë rriten bimët strehuese;
- 15.2. ka kushte të përshtatshme klimatike për përhapjen e këtij dëmtuesi në Kosovë;
- 15.3. bimët strehuese janë strategjikisht të rëndësishme;
- 15.4. ekziston mundësia që dëmtuesi të bëjë dëme të konsiderueshme (për mjedisin, shëndetin, ekonominë).
16. Sektori fitosanitar gjatë planifikimit të monitorimit merr parasysh kriteret dhe situatën e lartpërmendor (distribuim/përhapja e bimëve strehuese) në Kosovë, për të mbuluar tërë territorin e vendit.

 Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë	<b>PSO</b> <b>Procedurat Standarde të Operimit për monitorim</b>	<b>Dok.-Nr.: 07-109-003</b> <b>Versioni:</b> 1.0. <b>Faqe:</b> 5 <b>Statusi:</b> 31.01.2019.
<b>Manuali</b>		

17. Për dëmtuesit që nuk janë gjetur më parë në Kosovë, monitorimi për identifikimin e tyre duhet të bëhet në zonat e rrezikut:

- 17.1. pranë rrugëve, ku bimët strehuese mund të transportoheshin nëse përhapja e tyre nga ngarkesa është e mundur;
- 17.2. në treg, magazinim, vende të trajtimit dhe rritjes të bimëve strehuese dhe në afërsi të tyre,
- 17.3. në pikat e kontrollit kufitar dhe në afërsi të tyre;
- 17.4. në vendet ku bimët strehuese rriten për qëllime komerciale.

18. Për dëmtuesit që janë zbuluar në vende të caktuara në Kosovë, vëzhgimet e monitorimit dhe të kontrollit duhet të kryhen rreth vendit të infektuar, në zonat e rrezikut dhe vende tjera ku mund të bëhet përhapja e dëmtuesve.

19. Për dëmtuesit që kanë shpërndarje pak a shumë të barabartë në Kosovë, monitorimi i dëmtuesve duhet të bëhet në të gjitha rajonet, duke kontrolluar në mënyrë të barabartë tërë territorin. Monitorimi duhet të bëhet intensivisht në vendet ku është gjetur dëmtimi duke marrë parasysh:

- 19.1. shfaqjen e dëmtuesve në Kosovë;
- 19.2. përhapjen e bimëve strehuese, sidomos në vendet ku bimët strehuese janë rritur për qëllime komerciale;
- 19.3. biologjinë e dëmtuesve (cikli jetësor, etj.);
- 19.4. vendet me përshtatshmëri klimatike;
- 19.5. shpërndarjen dhe ndjeshmërinë e vektorëve (nëse ka vektor).

### III Dokumentimi i monitorimit

20. Duhet të shkruhet raporti i inspektimit për monitorim. Informacion sa më i saktë sa i përket inspektimit të bërë duhet të shënohet në reportin e inspektimit:

- 20.1. vendi ku është bërë inspektimi për të gjetur atë më pas. Në raste të veçanta duhet të matet zona (koordinatat GPS);
- 20.2. material i kontrolluar (bimë e kultivuar, bimë spontane), përdorimi i synuar;
- 20.3. zona në ha ose  $m^2$  dhe në rast të numrit të vogël të bimëve - numri i bimëve;
- 20.4. karakterizim i përgjithshëm;
- 20.5. prania ose mungesa e simptomave vizuale të dëmtuesve;
- 20.6. mostrimi në raste specifike.

21. Raporti i mostrimit plotësohet nëse është marrë mostra gjatë inspektimit.

22. Inspektori fitosanitar shënon informacione mbi monitorimin në shabllonin e përshtatshëm për raportim të monitorimit dhe një herë në vit (deri më 1 nëntor) e dërgon shefit të sektorit fitosanitar.

23. Shefi i sektorit fitosanitar i përbledh të gjitha informacione të pranuara në një tabelë vjetore të përbledhjes dhe i mban të gjitha dokumentet.